



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2661/ 5 prot.

Datë 16.11.2023

V E N D I M
Nr. 1168/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr. REF-81378-09-26-2023 me objekt “Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë (shkolla “Mustafa Gjestila” dhe shkolla “28 Nëntori”, Mat)”, me fond limit 7.587574 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KLAME” SHPK Nipt K2158003F
Rruga: “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, njësia Administrative nr. 11, Kodër – Kamëz.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mat
Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-09-2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81378-09-26-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë (shkolla “Mustafa Gjesticila” dhe shkolla “28 Nëntori”, Mat)” me fond limit 7,587,574. leke pa TVSH, zhvilluar më datë 09.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.

II.2. Në datën 09.10.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 24.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Klame” SHPK	4992400 leke	skualifikuar
2. “Erzeni/Sh” SHPK	7351820.0 lekë	kualifikuar
3. “Erald” SHPK	7415000 lekë	skualifikuar
4. “M.Lezha” SHPK	7517300 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 25.10.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e fituesit.

II.5. Operatori ekonomik “Klame” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, për listën e mallrave/ materialeve (mobilerie) objekt prokurimi të kërkuar, nuk janë paraqitur dëshmitë e testeve zyrtare të kryera për këto materiale/ pajisje, me qëllim vërtetimin e pajtueshmërisë së materialeve të prodhuara (ofertuar) me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

Për këto arsye në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

II.6. Në datën 31.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3551 dhe me nr. 2661/2023 prot., datë 31.10.2023, e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7 Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2661/2 prot., datë 01.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KLAME” SHPK kundërshton me anë të ankesës.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 5830/1 prot., datë 08.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2661/3 prot., datë 09.11.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.9 Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa nr. 5972 prot., datë 09.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2661/4 prot., datë 13.11.2023, me lëndë: *Dërgim Vendimi Nr. Prot 5830/1, datë 08.11.2023, për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: *“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:*

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, për listën e mallrave/ materialeve (mobilerie) objekt prokurimi të kërkuar, nuk janë paraqitur dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera për këto materiale/ pajisje, me qëllim vërtetimin e pajtueshmërisë së materialeve të prodhuara (ofertuar) me specifikimet dhe standardet e kërkuara.

Për këto arsye në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1”, neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik, shoqëria “KLAME” Sh.p.k., pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 b) ***Për Listën e mallrave/ materialeve mobilerie objekt prokurimi, listën si më poshtë:***

- *Tavolina nxënësi cikli ulët (120x64x45 cm)*
- *Tavolina nxënësi cikli i lartë (120x75x45 cm)*
- *Karrige nxënësi cikli ulët (35x38x37/70 cm)*
- *Karrige nxënësi cikli lartë (35x38x42/75 cm)*
- *Karrige për mësues me tapiceri (510x450x780 mm)*
- *Tavolina mësuesi (120x60x76 cm) cikli i lartë, arsimi i mesëm*
- *Dollap për klasa*

– *Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. *Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është vetë prodhues i mallrave/materialeve, ai duhet të paraqesë: Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për A.K. në rast verifikimi.*
2. *Me qëllim vërtetimin e pajtueshmërisë së materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specififikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, dhe **çertifikatat për produktet** si më poshtë:*
 - *Tavolina nxënësi cikli ulët, Tavolina nxënësi cikli i lartë, Karrike nxënësi cikli lartë, dhe Karrike nxënësi cikli ulët - SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2: 2012+ A1: 2015) ose ekuivalente me të, e përditësuar;*
 - *Karrike për mësuës me tapiceri dhe Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie - SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2: 2018 ose ekuivalente me të, e përditësuar;*
 - *Tavolina mësuësi (pune) - EN 527-1: 2011, SSH EN 527-2: 2016 + A1: 2019 ose ekuivalente me të, e përditësuar;*
 - *Dollap për klasa (raft) - SSH EN 14073-3: 2004, SSH EN 14074: 2004 ose ekuivalente me të, e përditësuar;*

Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çertifikatat e kërkuara të paraqiten nga operatorët në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “KLAME” SHPK në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

- Certifikate Konformiteti – EN-ISO 9001: 2015 me Nr. AQS/Q/73692021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME
- Certifikate Konformiteti – EN-ISO 3834-2:2015 me Nr AQS/Q/73732021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME
- Certifikate EN-ISO 3534-2:2016 me NR 002SM2022 lëshuar nga CERTIS ne emer te Shoqërise KLAME
- Autorizim Prodhuesi
- Certifikate Konformiteti Me Nr: KLS/231/QSCIPL-ALB-D5002 lëshuar nga SISTEMA Certifications and Inspections ne emer te Shoqërise KLAME
- Certifikate Konformiteti me Nr. QSCIPL-ALB/KLS/0923/C9721 lëshuar nga Sistema Certifications and Inspections ne emer te Shoqërise KLAME
- Certifikate Konformiteti me Nr. AQS/PAS/73742021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme 13 njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5 Në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 37 rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e

maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. 9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen e vërtetueshmërisë dhe pajtueshmërisë së materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi dhe **çertifikatat për produktet** e kërkuara shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin: “**dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi”. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin e

prokurimit elektornik shoqëria “KLAME” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri, ky i fundit ka dorëzuar Certifikata Konformiteti deklarate” *Certifikate Konformiteti – EN-ISO 9001: 2015 me Nr AQS/Q/73692021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME - Certifikate Konformiteti – EN-ISO 3834-2:2015 me Nr AQS/Q/73732021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME -Certifikate EN-ISO 3534-2:2016 me NR 002SM2022 lëshuar nga CERTIS ne emer te Shoqërise KLAME- Autorizim Prodhuesi-Certifikate Konformiteti Me Nr: KLS/231/QSCIPL-ALB-D5002 lëshuar nga SISTEMA Certifications and Inspections ne emer te Shoqërise KLAME-Certifikate Konformiteti me Nr. QSCIPL-ALB/KLS/0923/C9721 lëshuar nga Sistema Certifications and Inspections ne emer te Shoqërise KLAME -Certifikate Konformiteti me Nr. AQS/PAS/73742021 lëshuar nga AQScert ne emer te Shoqërise KLAME”.* Komisioni gjykon ,se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim nga autoriteti kontraktor, ka si synim që operatorët ekonomikë ofertues nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i ngarkuar në SPE nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me dëshmitë e testeve zyrtare të kryera, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi. Akoma me tej KPP ju sjell në vëmendje, se operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Sa më sipër kërkesa e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81378-09-26-2023 me objekt “Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë (shkolla “Mustafa Gjesticila” dhe shkolla “28

Nëntori”, Mat)” me fond limit 7,587,574. leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë derdhjen në buxhet të shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “KLAME” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Kryetar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

